

MEHMET ÇELIKU

ÇËSHËTJE TË NORMËS MORFOLOGJIKE NË LETËRSINË ARTISTIKE PAS ÇLIRIMIT

Struktura gramatikore e shqipes është përshkruar kryesisht në gramatikat shkollore e joshkollore. Në këto gramatika është dhënë gjërisht edhe struktura morfologjike e shqipes. Një punë e madhe është bërë sidomos në gramatikat e botuara pas çlirimit të vendit.¹

Karakteristikë e përgjithshme e këtyre gramatikave është se ato nuk e kanë karakterin normativ të nevojshëm, ato në disa raste nuk dallojnë format morfologjike normë, nga ato që janë dialektore e të vjetëruara dhe që në gjendjen e tanishme të gjuhës shqipe nuk përbëjnë normë. Kjo ka ndodhur, ndër të tjera, për arsye se vetë faktet gjuhësore e gjendja e zhvillimit të gjuhës shqipe, që pasqyronin gramatikat, sidomos ato të botuara para çlirimit, kanë qenë të tilla. Këtu do përmendur edhe faktori subjektiv: autorët e gramatikave janë nisur nga koncepte të ndryshme e të caktuara për gjuhën letrare, për bazën dialektore të saj. Pra faktet janë kodifikuar ashtu siç kanë qenë dhe në raste të tjera sipas traditës e sipas vlerësimit subjektiv të tyre.

Sot, siç dihet, ekziston një gjuhë letrare kombëtare shqipe², e cila megjithëse nuk ka një periudhë të gjatë që funksionon si e tillë, është njësuar mjaft dhe po ecën në rrugën e kristalizimit e normativizimit më të madh të saj. Në këto rrethana, kur vetë mjetet gramatikore në përdorim paraqiten pak a shumë të normuara, mund të kalohet edhe në kodifikimin e plotë të tyre në një gramatikë përshkruese normative. Por për njohjen e normës së gjuhës letrare, përpara se të hartohet një gramatikë e tillë, mund të shërbejnë edhe studime të veçanta teorike e praktike. Në këtë kumtesë³, që përbën një nga përpjekjet e para në këtë drejtim, do të trajtojmë disa çështje të përgjithshme të normës morfologjike në letërsinë artistike pas çlirimit.

1) Po përmendim vetëm K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949; Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe*, Botimi I, Tiranë, 1965.

2) I pari gjuhëtar që pranon se «ekziston në thelb një gjuhë e vetme letrare shqipe» është A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*, në «Shkencat shoqërore në shkollë», 2, Tiranë, 1967, f. 71.

3) Kumtesa që po botojmë në këtë numër të «Studimeve filologjike» është pregtitur për sesionin shkencor që do të mbahet në dhjetor 1969 me rastin e 25-vjetorit të çlirimit të Atdheut. Kjo kumtesë është një variant i shkurtër i artikullit më të gjërë: *Mbi qëndrueshmërinë e normave morfologjike në letërsinë artistike pas çlirimit*, e hartuar më 1968, 40 faqe. Çështjet e prekura në kumtesë kanë një karakter të përgjithshëm dhe do të shtrohen në formë konkluzionesh pa u ilustruar në mënyrë të kënaqshme, megjithëse kanë dalë nga analiza e një materiali të gjërë faktik që gjen pasqyrim në variantin e gjërë.

Konkretisht do të shohim disa nga karakteristikat kryesore të normës së sotme morfologjike. Duke u ndalë veçanërisht në kategorinë e variantshmërisë së normave morfologjike do të përmenden disa nga normat me variante, ose, si janë quajtur ndryshe, normat-dublete⁴ kryesore. Do të bëjmë një dallim brenda për brenda normave - dublete, do të jepen shkaqet e lindjes së normave-dublete dhe tendencën që ka ndonjëra prej tyre. Nga kategoria e variantshmërisë së normave do të dallojmë prerazi shmangjet nga norma dhe do të japim disa nga shmangjet më të dukshme në gjuhën e letërsisë artistike. Do të prekim kalimthi edhe disa ndryshime të normës morfologjike të publicistikës nga ajo e letërsisë artistike. Do të përpiqemi të japim edhe disa nga kriteret themelore që duhen pasur parasysh në normativizimin e normës morfologjike.

Duke u nisur nga nevoja për të ngulitur praktikisht normat morfologjike dhe për të kontribuar sado pak në kodifikimin sa më objektiv të normës dhe në pastrimin sa më të shpejtë të shqipes letrare nga format dialektore të panevojshme, do të mbajmë qëndrim lidhur me normat-dublete e me shmangjet.

Natyrisht çështjet e shtruara në kumtesën tonë nuk kanë gjetur një zgjidhje të plotë, prandaj ato presin të shihen më me nge dhe më për së afërmi në të ardhmen.

Kumtesa është mbështetur në një material të gjërë të vjelë nga veprat e letërsisë artistike të pasqirimit dhe veçanërisht në gjuhën e disa shkrimtarëve tashmë të njohur e që shkruajnë në gjuhën letrare të sotme kombëtare e jo në variantet letrare dialektore (duke përfshirë këtu edhe disa autorë me origjinë nga Veriu që shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare si Dh. Shuteriqi, A. Abdihoxa, F. Paçrami). Kemi pasur parasysh edhe disa autorë të tjerë për disa çështje të veçanta⁵. Për ndonjë çështje është përdorur edhe kartoteka e gramatikës e ngritur në Institutin e historisë dhe të gjuhësisë.

Këndi i vështrimit tonë është padyshim i ngushtë, përderisa kufizohemi vetëm në letërsinë artistike duke lënë kështu normën morfologjike të publicistikës, e cila ka luajtur dhe luan një rol të madh në ngulitjen e normës morfologjike të shqipes.

* * *

Një nga vetitë kryesore të gjuhës letrare është qëndrueshmëria e saj, e cila është e lidhur me normën. Sa më e ngulitur të jetë norma në hallka të ndryshme të strukturës fonetike, gramatikore e leksikore aq më e qëndrueshme paraqitet gjuha letrare. Pikësynimi ynë është pikërisht ky: të kemi një normë sa më të ngulitur, për të pasur edhe një gjuhë letrare kombëtare sa më të qëndrueshme.

Ç'është norma gramatikore? Me normë gramatikore kuptohet zakonisht «tërësia e rregullave gramatikore të nxjerra nga praktika gjuhësore, që ka për qëllim të drejtojë e të rregullojë veprimtarinë ligjëri-more të folësve në një gjuhë të caktuar»⁶. Pra termi «normë gramatikore» ka dy kuptime: së pari, norma kuptohet si një përdorim i mje-

4) A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, në «Studime filologjike», 2, 1968, f. 54.

5) Shiko listën e veprave të vjela që pason kumtesën.

6) O.S. Ahmanova, *Slovar' lingvističeskijh terminov*, Moskva, 1966. f. 271.

teve gramatikore që ekzistojnë objektivisht e që ky përdorim është i pranueshëm prej të gjithëve; së dyti, me normë kuptohet edhe tërësia e rregullave të përdorimit të mjeteve gramatikore të ngulitura (e të re-komanduara) në gramatikë. Në rastin e dytë kemi të bëjmë me kodifikimin e normës gramatikore, që ekziston objektivisht e që duhet kuptuar si vendosje e rregullave të fjalëformimit, të trajtëndryshimit, të ndërtimit të togfjalëshave e të fjalive⁷.

Si paraqitet norma morfologjike në letërsinë artistike shqipe pas çlirimit?

Gjendja e përgjithshme është kjo: në strukturën morfologjike të letërsisë artistike pas çlirimit vihen re këto tri dukuri: 1) norma të ngulitura unike (të vetme); 2) variante normash të pangulitura ose norma në dy variante dhe 3) largime ose shmangje nga norma.

Normat zotëruese që përcaktojnë strukturën morfologjike të letërsisë artistike në shumicën dërmuese janë të ngulitura, të fiksuara. Norma të tilla të formuara përfundimisht do t'i quajmë norma unike. Kështu p.sh. format me mbaresat *-ja, -je -(n)te* të së pakryerës janë norma unike, sepse sot për tri vetat e njëjësit përveç këtyre formave, nuk ka forma të tjera paralele që të përbëjnë normë.

Normat e ngulitura unike zotërojnë në sistemin emëror, mbiemëror, përemëror, foljor etj.

Pranë normave unike, por shumë më rrallë se ato, sot takohen edhe norma dyvariantëshe; ose ndryshe norma-dublete. Variantshmëria e normës, dmth. fakti që norma lejon edhe dy mënyra shprehjeje është një gjë e njohur tashmë në gjuhësi⁸. Në këto raste kemi të bëjmë me forma paralele, krejtësisht identike për nga kuptimi, përdorimi dhe nga nuanca stilistikore. Kështu p.sh. ne njohim sot për normë praninë e dy varianteve *aeroplanë-aeroplana, grushta-grushte* që ndodhen brenda kufijve të normës; format paralele *shiun* edhe *shinë* janë gjithashtu norma dyvariantëshe.

Së fundi, përveç normave unike dhe normave-dublete përdoren në shumë raste edhe shmangjet nga norma.

Shmangje kemi atëhere kur në vend të një modeli të pranuar si normë, në të njëjtin kuptim e në të njëjtën nuancë stilistikore, përdoret një mjet tjetër gramatikor që gjen një përhapje më të kufizuar. Ndryshe mund të thuhet, shmangje kemi sa herë kur një ose disa autorë largohen nga normat e vetme të ngulitura ose nga normat-dublete dhe përdorin, goftë edhe në mënyrë sistematike, një formë dialektore, arkaike, ose të gabuar. Shmangjet janë më të shumta në numër, më të larmishme se sa normat-dublete, por ndryshe nga këto të fundit, shmangjet kanë një përdorim më të kufizuar, një shtrirje më të vogël, herë-herë vetëm sporadike (takohen në autorë të caktuar, në vepra të caktuara dhe me një denduri të pakët përdorimi). Kështu p.sh. përdorimi i emrave në të ashtuquajturën rasë vendore, ose përdorimi i tipit *shkrojt* në të kryerën e thjeshtë janë të papranueshëm dhe nuk përdoren nga shumica e autorëve, prandaj ky përdorim përbën shmangje nga norma.

Duke studjuar karakterin e dukurive që u zunë ngoje më lart, raportin midis tyre, ndryshimet që kanë pësuar ato si dhe shkaqet e lindjes së tyre, dalin disa përfundime të një karakteri të përgjithshëm.

7) V.A. Ickoviç, *Jazykovaja norma*, 1968, faqe 4.

8) V.G. Kostomarov, *Kultura jazyka i rjeçi v svjete jazykovoju politike*, në «Jazyk i stil», izdatjelstvo «Mysl», Moskva, 1965, f. 47.

Përfundim

ç'është
norma
unike?

ç'është
norma
dublete?

ç'është
shmangjet

I. Struktura morfologjike në letërsinë artistike pas çlirimit në shumicën dërmuese të aspekteve të saj paraqitet e kristalizuuar, dhe, në krahasim me periudhën e paraçlirimit e të viteve të para të pasçlirimit, procesi i kristalizimit dhe normalizimit të saj ka ecur më përpara. Këtë e vërtetojnë këto gjëra:

1. Normat unike, siç u tha më lart, janë zotërueset, ndërsa normat-dublete janë të pakta në numër. Në sistemin emëror mund të përmenden, ndër të tjera, këto dy norma-dublete themelore. Këto janë pikërisht shumësi i disa emrave mashkullorë dhe kallëzorja e shquar e emrave mashkullorë me temë në zanore të theksuar. Çiftet kryesore të formave paralele në shumësin e emrave janë këto: -ë:a, e:a, -e:ë, më rrallë (-):a: *aeroplanë-aeroplana, çengelë-çengela, bilbilë-bilbila, shoferë-shoferi, dentistë-dentista; autobuze-autobuza, grushtë-grushta, puse-pusa, xhame-xhama, xhepe-xhepa; çorape-çorapë, dyqane-dyqanë, pullaze-pullazë*. Emrat që kanë në shumës forma të tilla paralele janë relativisht shumë. Në paralelizmin -ë:-a format më produktive janë ato me mbaresën -ë, në -e:-a raporti është në të mirë të -e, megjithëse shpërpjestimi nuk është aq i madh. Autorët veriorë që shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare (si Dh. Shuteriqi, A. Abdihoxha) i përdorin shumësat me -a më dendur, megjithatë dhe për këta autorë modelet me -ë, -e janë më produktive. Në modelet paralele -e:-ë, që nuk janë aq produktivë sa ato që u panë më lart, raporti është në të mirë të -e.

Lidhur me normat dyvariantëshe të shumësit po bëjmë edhe disa shënime të tjera: a) Forma të tjera paralele ose ato që u panë më lart, vihen re jo vetëm në radhën e emrave të një tipi, por te të njëjtat fjalë, tek i njëjti autor, në të njëjtën vepër: *yj-yje, kufi-kufij, gjyshë-gjyshër, prind-prindër, lufta-luftëra* (P.M.); *filxhanë-filxhane, xhama-xhame, kallinj-kallëza* (I.K.); *prind-prindër, gishta-gishtërinj* (Dh.Sh.); *yje-yj* (A.A.); b) Emrat që përdoren më pak si edhe disa nga ata që janë huajtur nga gjuhët e tjera kanë shpesh një formë të pakristalizuuar në shumës: *ujvare-ujvara, qiparise-qiparisa, kordonë-kordona, altoparlantë-altoparlante*; c) Format paralele shfaqen nganjëherë vetëm gjatë lakimit të emrit: *yje-yjve, qen-qenëve, fqinj-të fqinjëve*. ç) Disa emra, përveç dy formave paralele që ndodhen në kufijtë e normës kanë edhe një formë të tretë të përdorur shumë rrallë e që në këtë rast përbën një shmangjë nga norma dyvariantëshe: *aeroplanë-aeroplana-aeroplane, mitralozë-mitraloza-mitraloze, flamurë-flamuj-flamure, krevatë-krevate-krevata, kordonë-kordona-kordone, prind-prindër-prindë*.

Materiali tregon se në gjuhën e letërsisë artistike vihet re një shtrirje e mbaresës -a në dëm të mbaresës ë (që është më produktive në Jug) e të mbaresës zero. Kjo tendencë është e fortë dhe ka ndodhur nga ndikimi i dialektit të Veriut, ku shumësi me a është mjaft i përhapur⁹, nga veprimi analogjik i modelit ekzistues me mbaresën -a (*plepa, emra*), si edhe nga nevoja për një karakterizim më të mirë material të formave të shumësit, sepse mbaresa -a ka një kumbim fonetik e ekspresivitet më të madh¹⁰. Kjo shtrirje bëhet e nevojshme sidomos për gjuhën letrare të folur, ku, siç dihet, ë fundore ka prirje të reduktohet. Pra këtu ka li-

9) M. Çeliku, 1) *Vëzhgime mbi të folmen e Kërrabës I*. «Studime Filologjike» 3, 1966, f. 137; 2) *Vëzhgime mbi të folmen e krahinës së Peqinit*, «Studime filologjike», 4, 1965, f. 104; 3) *Mbi grupimin e të folmeve të gegërishtes jugore*, «Studime filologjike», 3, 1968, f. 128. B. Beci, *Hulumtime gjuhësore në Mat*, «Bulet. i Univ. Sht. të Tiranës», 2, 1963, f. 212.

10) E. Çabej, *Rreth disa çështjeve të historisë së gjuhës shqipe*, «Buletin i USHT, Seria shkencat shoqërore», 3, 1963, f. 75.

ndur nevoja e të përdorurit të formave sa më të diferencuara. Të gjitha këto janë në favor të ngritjes në normë të variantit me *-a*.

Pavarësisht nga këto faktorë në të mirë të variantit me *-a*, mendojmë që mbaresa *ë* dhe mbaresa zero e kryejnë plotësisht funksionin e mbaresës së shumës, që vërtetohet me modelet e qëndrueshme ekzistuese si *puntorë, vullnetarë, dursakë; javë, lugë, anë* që janë të vetmet forma të mundshme për shumësin e këtyre emrave. Sidoqoftë, ne mendojmë që ngritja në normë e variantit me *-ë* do lidhur edhe me normën sot për sot unike të vetës së III të lidhores të tipit të *kapë* (kundrejt formës të *kapi* që sot për sot është shmangje) etj. Për disa emra të caktuar do mbajtur një qëndrim i veçantë. Kjo punë duhet të gjejë shprehje në radhë të parë në fjalorin e ardhshëm të shqipes. Përndryshe, ka shumë të ngjarë që format me *-a* të shtrihen edhe më thellë.

Norma dyvariantëshe tjetër e sistemit emëror, që mund të mbahet si kryesore është kallëzorja e shquar e emrave mashkullorë që mbarojnë në temë me një zanore të theksuar. Shumë nga këta emra që janë rreth 30, ndër të cilët përfshihen edhe disa emra njerëzish me origjinë turkoarabe, kanë nga dy forma paralele në kallëzore: *ariun, njeriun, syun, shiun, traun*, por edhe *arinë, njerinë, synë, shinë, tranë*. Po shtojmë këtu se format e vjetra pa zanore përpara mbaresës, me përjashtim të emrit *vëlla* që del gati rregullisht në trajtën *vëllanë*, janë më anësore, përdoren më rrallë. Sidomos në vitet e fundit kanë prirje të përhapen format me zanore epentetike; në publicistikë kjo prirje është akoma më e theksuar. Duke u nisur nga këto dy arsye kujtoj se projekti i Drejtshkrimit i 1967 duhet të kishte parapëlqyer më shumë për normë format e reja me zanore epentetike.¹¹

Edhe në sistemin foljor normat-dublete janë të pakta; po përmendim vetëm këto: për vetën e dytë shumë të së tashmes për foljet *kam, jam* përdoren njëkohësisht mjaft dendur: *keni, jeni; kini, jini*; për vetën e III të së pakryerës njëjës për foljet *kam, jam* përdoren *kishte, ishte*, dhe *kish, ish*; për shumësin e foljeve me temë në *t* përdoren format paralele *thërrisnim; thërritnim*; për të ardhmen përdoren forma e plotë e tipit *do të punoj* dhe ajo e shkurtuara *do punoj*, për aoristin e foljes *dua*, veta e III njëjës, përdoren format *deshi; desh*.

Natyrisht, përveç këtyre normave-dublete ekzistojnë edhe disa të tjera, siç janë trajtat e shquara të emrave të tipit *radjo*, përdorimi paralel i trajtës së pashquar në vend të trajtës së shquar, ndërrimi i gjinisë dhe ruajtja e saj për disa emra në shumë, korelacioni kohor i disa foljeve, përdorimi paralel i disa fjalëve shërbyese etj.

2. Në gjuhën e letërsisë artistike disa forma paralele kanë fituar një përdorim të kushtëzuar; secili variant ka një kuptim të caktuar dhe përdoret në ndërtim të caktuara. Kështu p.sh. forma arkaike e asnjanë-sit të emrave të tipit *ujë-t* sot përdoret kryesisht në frazeologji, ndërsa në përdorimin neutral, me përjashtim të ndonjë autori¹², normë përbën forma e gjinisë mashkullore (*ujë-uji*).

Një shembull tjetër përdorimi të kushtëzuar të formave paralele është ai i varianteve të rasës rrjedhore. Sot në gjuhën letrare shqipe përdoren dy forma të rasës rrjedhore të pashquar shumë, forma e vjetër me *-sh* dhe ajo e reja me *-ve*.

11) Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (Projekt), Tiranë, 1967, f. 21, 42.

12) P.sh. J. Xoxa përdor mjaft dendur asnjansin ujët.

Asi kemi parë kushtet e përdorimit dhe pasi kemi bërë analizën e përdorimit të tyre, gjë që nuk mund të jepet dot në këtë kumtesë, rezulton se secila nga këto forma ka kuptime të ndryshme dhe përdoret në kushte të ndryshme të caktuara mirë. Ato përbëjnë sot variante të kushtëzuara norme. Sot rrjedhja me *-sh* përdoret gjërësisht në konstrukte joparafjalore në funksion atributiv, më rrallë edhe në ato parafjalore në funksion rrethor. Emrat në rrjedhore me *-sh* nuk janë të shquar. Forma me *-ve* përdoret e prirë nga parafjalë të ndryshme dhe emrat në këtë formë janë të shquar (në mos formalisht, kuptimisht domosdo).

Në rastin e normave-dublete të kushtëzuara kristalizimi është më i madh se në rastin kur normat-dublete kanë një përdorim të lirë, të pakushtëzuar.

Në dallim nga normat-dublete të pakushtëzuara që janë të mirëfilltat, të zakonshmet, ku norma lejon dy mënyra paralele të shprehuri, në rastin e normave-dublete të kushtëzuara nuk lejohen dy mënyra paralele të shprehuri, sepse tashmë njëri variant zakonisht e përjashton tjetrin. Kushtëzimi shpjegohet me funksionet e caktuara që kryen çdo variant si dhe me kushtet e caktuara të përdorimit, prandaj variantet e kushtëzuara janë dhe mund të mbeten në të ardhmen në funksione të caktuara. Sot përbën normë pikërisht përdorimi i kushtëzuar i këtyre varianteve. Në raste të rralla kur shkelet ky përdorim i kushtëzuar (p.sh. përdoret asnjësi i tipit *ujët* jasht ndërtimeve frazeologjike, ose përdoret forma me *-sh* në vend të asaj me *-ve*, apo anasjelltas, ose përdoret parafjala *prej* në funksionet e *nga*, kemi të bëjmë me shmangje nga normat-dublete të kushtëzuara.

Sint. morl. Ndërsa në publicistikë rastet e përdorimit në konstrukte «paralele»¹³ të parafjalëve *nga* e *prej* janë më të dendura, në gjuhën e letërsisë artistike kemi vënë re një specifikim e kushtëzim funksional të tyre, të cilat rrallëherë janë duke u përdorur njëra në vend të tjetrës.

Sot parafjala *prej* përdoret kryesisht në togfjalësha të caktuar ku komponenti i dytë tregon 1) lëndën nga e cila ndërtohet, përbëhet një send (ky është edhe përdorimi kryesor i saj dhe e vetmja mundësi për të shprehur këtë funksion sa kohë që komponenti i parë është i shquar¹⁴): «rrobet e zeza *prej* shajaku» (I.K., Dasma, 38); 2) karakteristikën, cilësinë e një sendi: «mëndje *prej* çilimiu» (S.S., Buzë, 72); 3) Një përdorim të gjërë ka *prej* përpara përemrave që tregojnë pjesën e një të tërë, vepruesin, shkaku e një veprimi, largimin etj. «E mira është të flasë njëri *prej* nesh (S.S., Ata... 29); «Milicët zvarras u afroreshin pozitivave të çetës, po goditeshin *prej* saj (P.M., Stina... 221); «Mos ka turp *prej* meje (P.M., Has... 263); Dikush u shkëput *prej* tyre e doli në buzë të rrugës (Sh. M., Para... 142). 4) Parafjala *prej* përdoret në ndërtimet *emër+prej+numëror në rrjedhore me -sh* për të treguar thjesht sasi, sasi numerike, masë në kohë, në distancë etj. «Mbi një shtresë *prej* dy pëllëmbësh» (S.S., Ata... 29); «... dilte një copë dru, që shkurtonte mirë lartësinë *prej* katër metrash nga dritarja në kopsht» (Sh.M., Para..., I, 346); «I lypa zonjës edhe një afat *prej* një vjeti dhe ajo pranoi...», (Sh. M., Para... I, 410). 5) *prej* përdoret në togfjalësha ku komponenti i dytë, du-

13) V.P. Subotin, *Sintaksiçeskaja sinonimika v sovremjonnomazykye*, Moskva, 1960.

14) G. Weigand, *Albanische Grammatik*, f. 85; K. Cipo, *Gramatika shqipe*, Tiranë, 1949, f. 182; A. Xhuvani, *Parafjalët*, «Studime filologjike», 1, 1964, f. 35.

ke emërtuar një fragment kohor, tregon kohën sa zgjat një veprim: «Atje banonte prej disa muajsh Filja e bukur bashkë me të jëmën» (A.A., Tri. . . , 135); «Prej vjetësh në Korçë banonte Stiri» (S.S., Ata. . . 5); 6) *prej* përdoret edhe në ndërtime me përsëritje të së njëjtës fjalë si në tipet: gjë *prej* gjëje, një ditë *prej* ditësh etj. Këto janë funksionet kryesore të parafjalës *prej* që sot përbëjnë normë në letërsinë artistike dhe që, për mendimin tonë, kanë shumë mundësi të ngrihen në normë në mbarë gjuhën letrare kombëtare. Për të treguar shkaku e ndonjë veprimi, personin ose sendin veprues, pikënisjen e një veprimi, largimin nga një send dhe nuanca të tjera vendore, origjinën etj. përdoren togfjalëshat që përmbajnë parafjalën *nga*. Përdorimi i parafjalës *prej* në këto funksione është për gjuhën e letërsisë artistike një shmangje. Kjo shmangje është sporadike në autorët jugorë dhe më e fortë tek autorët veriorë që shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare e që janë në një farë mase akoma nën ndikimin e dialektit verior.

Në variantin letrar geg *prej* është përdorur shumë më tepër dhe ka pasur më shumë funksione se sa *nga*. Shumë më pak se në variantin letrar geg, por pak më shumë se në periudhën e pasçlirimit *prej* është përdorur edhe në variantin letrar tosk (krahaso p.sh. S. Frashërin e F. Nolin), ku p.sh. vepronjësi shprehet zakonisht nga një emër i prirë nga parafjala *prej*.

Ndërtime paralele përbëjnë edhe togfjalëshat me parafjalët *më, në*, por ky paralelizëm ka sot një karakter të kushtëzuar. Sot përdorimi i *më* është kufizuar kryesisht në ndërtime arkaike, siç janë ndërtimet me përsëritje, shprehjet frazeologjike, ndërsa në ndërtimet e tjera jofrazeologjike përdoret zakonisht *në*. «Rudi buzëqeshi vesh më vesh» (I.K., Dasma, 20); «Nurja kish vajtur portë më portë» (F.Gj., Ujët. . . , 9); «Plaku vuri buzën më gaz. . . » (Dh. Sh. Kë. e Pu., 8); «. . . kishte marrë më qafë të shkretin laroj» (Dh. Sh., Këngë 13).

Këto përdorime sot përbëjnë normë, megjithatë ka raste kur në të njëjtin funksion i njëjti autor, në të njëjtën veper përdor njëkohësisht ndërtime me *më e në*: «Tjetri qëndroi në këmbë» (Dasma, 22); por edhe «. . . shkoi e qëndroi më këmbë pranë dyerve të vagonit» (Dasma, 98); ose disa autorë rrallëherë përdorin në ndërtime jofrazeologjike edhe *më*: «Po të pish raki me karar, më ndonjë gosti. . . » (Dh.Sh., Kë. e Pu., 97); «. . . të ishim ulur më një rrëzë e të qeshnim. . . » (P.M., Hasta, 222). Sot *më* përdoret edhe në togfjalëshat ku shprehen raporte kohore, zakonisht para datave por edhe para fjalësh të tjera që tregojnë fragmente kohore: «. . . ja se ç'ndodhi pasi më ra të fikët në stacionin alpinistik të Bixës, më 19 maj.» (M. Kallamata, Netë gjahtarësh, 1959, 14).

3. Disa forma paralele të variantit letrar jugor, që para çlirimit kishin një përdorim të gjërë në atë variant¹⁵ e që në disa raste kanë vijuar të përdoren edhe pas çlirimit, sidomos në vitet e para të pasçlirimit, janë eliminuar, duke kaluar njëra formë në normë unike të ngulitur, dhe forma tjetër në mos është eliminuar plotësisht, ka përfunduar në shmangje. Të tilla janë p.sh. format për kallëzoren e emrave me bashkëtingëllore *lisnë*: *lisin*, që sot është eliminuar në të mirë të formës *lisin* që përbën normë; format paralele për kallëzoren e pashquar me të ashtuquaj-

15) Në qoftë se disa vite përpara çlirimit ose në prag të çlirimit këto janë forma paralele, në një kohë më të largët, p.sh. gjatë periudhës së Rilindjes disa nga format e mësipërme kanë qenë format e vetme, që përbënin normë në kuadrin e variantit letrar jugor.

turën «rasë vendore», e cila nuk e njeh më sot atë përdorim të gjërë që kishte në periudhën e Rilindjes dhe ka kaluar në shmangje; format paralele të së kryerës së thjeshtë të foljeve me temë në bashkëtingëllore të tipit *kapmë, kaptë, kapnë: kapëm, kapët, kapën*, nga të cilat format e para sot janë eliminuar (rrallë ato pas çlirimit janë përdorur nga ndonjë autor si p.sh. nga F. Gjata, Sh. Musaraj).

4. Normat-dublete ekzistuese, siç duket edhe nga ato pak raste që u dhanë më lart, nuk shtrihen në tërë paradigmat, por vetëm në aspekte të veçanta të këtyre paradigmave p.sh. vetëm në kallëzoren e shquar e jo në rasat e tjera. Gjithashtu normat-dublete shtrihen në grupe të caktuara fjalësh ose në fjalë të caktuara (kujto p.sh. shumësin e disa emrave mashkullorë dhe format e disa foljeve të caktuara).

II. Ndryshe nga normat-dublete që janë mjaft të kufizuara në numër, shmangjet janë të një numri më të madh. Kjo shpjegohet me faktin se një palë e formave paralele ose disa forma të vetme të variantit letrar jugor kanë kaluar në shmangje (si p.sh. asnjanesi *ujët*, kallëzorja *lisnë*, vendorja *në list*, aoristi *kapmë*) si edhe me ndikimin e të folmes lokale të shkrimtarëve, duke qenë ato (shmangjet) karakteristike për autorë të caktuar (si p.sh. aoristi *shkrojti, lojti*; lidhorja *të kapish, të kapi*; prapashitesa e zvogëlimit *kë* me një përdorim të ekzagjeruar *dyqankë* etj.). Shmangjet janë të shumta në numër por, nga ana tjetër, ato kanë një shtrirje të kufizuar dhe kanë një denduri përdorimi mjaft të vogël.

III. Si shpjegohet ekzistenca e normave dyvariantëshe dhe shmangjet? Normat-dublete dhe shmangjet kanë lindur ndër të tjera a) nga vetë zhvillimi objektiv i gjuhës, nga shfaqja e tendencave të reja në gjuhë; këto janë norma-dublete si shfaqje objektive të zhvillimit të gjuhës që natyrisht ka ndodhur për shkaqe të ndryshme (si p.sh. format e reja të kallëzores me zanore epentetike etj.); b) duke pasur parasysh specifikën e gjuhës letrare shqipe, normat-dublete e shmangjet kanë lindur edhe nga ndikimet dialektore (dialekt apo të folme), mbartës të të cilëve janë vetë autorët dhe korektorët e redaktorët e veprave të tyre (si *kish-te:kish, ishte:ish, keni:kinë, jeni:jini; desh:desh, të kapë:të kapi* e këtu duhen futur edhe krijimet analogjike të tipit *florinë, përroin*; aoristi *shkrojti, oshëtiti*, pjesorja e tipit *mbështjellur* etj.). Faktori i dytë është kryesori për sa u përket shmangjeve.

Shkaqet e lindjes së normave-dublete dhe shmangjeve duhen kërkuar në specifikën e në kohën e formimit të gjuhës letrare kombëtare shqipe, që është relativisht e re e që është formuar nga një bashkëveprim ndër-dialektor i varianteve letrare dialektore¹⁶.

Më pak normat-dublete e më shumë shmangjet kanë pasur mundësi të futen në gjuhën e letërsisë artistike edhe nga ndikimi i drejtpërdrejtë i redaktorëve dhe i korektorëve letrarë e gjuhësorë. Ç'është e vërteta, disa dukuri që vihen re sot në gjuhën e letërsisë artistike janë veçori të korektorëve e redaktorëve letrarë edhe jo të shkrimtarëve, megjithatë për ne ka rëndësi fakti se në këto vepra gjen shprehje ndërgjegjja gjuhësore e kohës.

IV. Shumica e shkrimtarëve tanë i njohin dhe po përdorin sot format morfologjike normë. Kjo gjë bëhet shumë e dukshme vitet e fundit. Megjithatë disa autorë dalin për çështje të veçanta nga kufijtë e normës, duke pasqyruar kështu ndikimet lokale të vendlindjes: kor-

16) A. Kostallari, **Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare**, në «Shkencat shoqërore në shkollë», 2, 1967.

çarizma vërehen tek shkrimtarët korçarë (S. Spasse), labizma e gjirokastrizma tek disa shkrimtarë jugorë (Sh. Musaraj, Z. Sako).

Pas çlirimit, kryesisht në vitet e para dhe më rrallë në periudhën e mëpastajme, disa autorë kanë shkruar vepra që nuk mund të vihen në një plan me veprat e dala kohët e fundit, të cilat e pasqyrojnë më mirë normën morfologjike. Kështu p.sh. në veprat «Ujët fle hasmi s'fle» të F. Gjatës (1951), «Ata nuk ishin vetëm» të S. Spasses (1952), madje edhe në veprat e botuara kohët e fundit si «Buzë liqenit» të S. Spasses (1965), «Para agimit» të Sh. Musarajt (1965, 1966), ku më shumë e ku më pak, vihen re akoma lidhje të forta me variantin letrar jugor (të kujtojmë p.sh. se në këto vepra gjejnë vend, ndër të tjera, forma të tilla dialektore si aoristi: *shkelmë, duallë, shkrojt, krojti, përgjojt*; kallëzorja *zjarrë, mëngjezë*; vendorja: në *kullët, në qeveritë*; format pësore *duhesh, kruhesh, përgatitesh* etj.). Kjo gjendje shpjgohet me ndikimin e fortë të gjuhës popullore tek autorët e mësipërm, me ndikimin e dialektit verior tek disa prej tyre dhe me mungesën e një redaktimi serioz të këtyre veprave, që, të gjitha së bashku, në fund të fundit, tregojnë vetë gjendjen dhe shkallën e normativizimit të gjuhës letrare kombëtare.

Duhet përmendur edhe grupi i shkrimtarëve veriorë që tashmë shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare, të cilët, me gjithë sukseset që kanë arritur në këtë drejtim, kush më shumë e kush më pak, ruajnë akoma forma nga dialekti i Veriut (Dh. Shuteriqi, A. Abdihojha), por që në ndonjë rast përbëjnë kontribut në përsosjen e gjuhës së letërsisë artistike (p.sh. ndërsa në publicistikë, në letërsinë politike, shkencore, filozofike janë ngritur në normë mbiemrat foljorë me *-shëm*, në letërsinë artistike sot për sot këto forma kanë filluar të futen kryesisht nëpërmjet këtyre shkrimtarëve). Natyrisht grupi i shkrimtarëve veriorë që shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare është larguar shumë nga shkrimtarët veriorë që vazhdojnë të shkruajnë akoma në variantin letrar verior, të cilët në vetvete i janë afruar mjaft gjuhës letrare kombëtare, sidomos normave të saj morfologjike.

V. Megjithëse nuk kemi bërë kërkime të posaçme në publicistikë, në vija të trasha kemi vëmë re disa veçori të përgjithshme të gjuhës së letërsisë artistike në dallim nga gjuha e publicistikës në punën e ngulitjes së normës morfologjike. Kjo shpjgohet në radhë të parë me vetë gjininë, llojin e stilit (publicistika ka një stil më unik), me gjerësinë e letërsisë artistike, me karakterin më të theksuar individual të prodhimeve letrare, me korektimin letraro-gjuhësor të letërsisë artistike që bëhet nga shumë persona dhe ku dora e korektorëve është më e frenuar, së fundi, në një farë mase edhe me vetë traditën.

Për këto arësyje në gjuhën e letërsisë artistike ruhen akoma disa forma të vjetra të përdorura në frazeologji ose jasht frazeologjisë (siç është asnjëherë i tipit *ujë-t*), ruhen më shumë shmangje (të përdorura këto në karakterizimin e personazheve ose jo) si p.sh. e ashtuquajtura «rasë vendore», format e dialektit verior të lidhore të tipit *të kapi, të kapish*, format e aoristit të tipit *kapmë* etj.

Ndërkaq në publicistikë shmangjet janë më të kufizuara, takohen më rrallë, në ndonjë pikë ndikimi i dialektit verior është më i dukshëm, p.sh. aty përdoret shumë më tepër tipi i mbiemrave foljorë me *-shëm* (kundrejt asaj pa *-shëm*: si *i dëgjueshëm: i dëgjuar*) tipi i emrave dhe mbiemrave me prapashtesën *-(ë)s* nga tema e pjesores (kundrejt trajtës së përftuar nga tema e së tashmes, si *zbulues: zbulonjës*); në publicistikë, gjithmonë nën ndikimin e variantit letrar verior, vihet re një për-

dorim i theksuar paralel i konstrukteve me parafjalët *nga, prej*), si edhe një përdorim më i madh i mbiemrave me prapashtesat *-or, -ore* në vend të emrit në gjindore që shpjegohet me natyrën e stilit publicistik etj.

Në gjuhën e letërsisë artistike sot përbëjnë normë emrat vepronjës dhe mbiemrat të formuar nga e tashmja: *zbulonjës, parakalonjës, shfryt-zonjës, sulmonjës, zapttonjës, qortonjës*; «gishtin tregonjës», «plasje shurdhonjës», «tingujt vajtonjës», «shelgje lotonjës».

Vetëm autorët veriorë që shkruajnë në gjuhën letrare kombëtare përdorin paralelisht «lodër ngazëlluese», «kukurizma tingëlluese», «heshtje qortuese», por edhe «turma ngazëllonjës», «me kukurismën e saj tingëllonjës», «zë qortonjës» (A.A., Tri...)

Nga ana tjetër, kanë fituar me shtrirjen e tyre të gjërë rastet e veçanta *mësues, shërbyes* (por takohen edhe *mësonjës, shërbenjës*).

Në publicistikë gjendja paraqitet krejt ndryshe; këtu po zotërojnë format me *-(ë)s* nga pjesorja.

Këtu kemi një rast që tregon se variantet e përdorura përkatësisht në publicistikë dhe në letërsinë artistike përbëjnë një normë-dublet vetëm në kuadrin e përgjithshëm të gjuhës letrare kombëtare dhe jo në stile të veçanta të saj.

Duhet pranuar se publicistika ka ndikuar në mënyrë vendimtare në ngulitjen e normës të gjuhës së letërsisë artistike në veçanti dhe të gjuhës letrare kombëtare në përgjithësi. Kjo ka ndodhur se publicistika është relativisht e gjërë, është gjinia më masive (lexohet nga masa e gjërë) dhe më korente etj.. Këtë ndikim ne e shohim, përveç fonetikës, në morfologji, sepse pikërisht kjo është një nga fushat ku stili unik i publicistikës ka mundësi të ndikojë më shumë përdërisa normat e saj janë të përbashkëta me ato të gjuhës së letërsisë artistike. Ndërkaq nevoja për të përdorur një fjalor më të pasur dhe konstrukte më të larmishme e bën publicistikën e paaftë që ta luajë atë rol vendimtar edhe në fushën e fjalorit e të sintaksës.

VI. Normat-dublete dhe shmangjet në gjuhën e letërsisë artistike shprehin gjendjen e tanishme të gjuhës letrare shqipe, e cila është në rrugën e kristalizimit të plotë të saj. Këto norma dyvariantëshe e shmangje janë, për një masë të madhe, të paevitueshme për fazën e tanishme të gjuhës letrare kombëtare shqipe. Në të ardhmen duhet studjuar më me hollësi gjendja dhe duhet shpejtuar me ndërgjegje ritmi i kristalizimit të gjuhës letrare. Për këtë gjë kërkohet një punë më e madhe dhe një përpjekje e ndërgjegjshme jo vetëm nga gjuhëtarët, shkrimtarët, gazetarët, korektorët e redaktorët, por nga tërë ata që e përdorin shqipen letrare.

Të shpejtuarit me ndërgjegje të normativizimit të gjuhës letrare ne e kuptojmë kështu: dihet se vendosja e normave shihet si një zhvillim objektiv i gjuhës letrare, i pavarur nga vullneti i njerëzve; por megjithatë, ky zhvillim objektiv mund të shpejtohet me një ndikim të jashtëm, gjithmonë në bazë të njohjes së tendencave të zhvillimit dhe përdorimit aktual të mjeteve gjuhësore. Prandaj përsa u përket normave-dublete duhet të përpiqemi të gjejmë e të njohim prirjen, tendencën që ka njëri apo tjetri variant dhe të caktojmë variantin që ka më shumë arësye e mundësi (që është më i përshtatshëm, më i drejtë, më i preferuar) të ngrihet në normë. Por këtu do pasur parasysh edhe mundësia e specifikimit funksional që mund të marrë varianti tjetër e si rrjedhim mundësia e ngritjes në normë e të dy varianteve. Për këtë gjë, duhen kërkime speciale, kërkime statistikore, duhet analizuar përdorimi i formave parale-

le, kuptimi i tyre, të dhënat dialektologjike dhe historike dhe të tjera rrethana. Në kriteret themelore për normativizimin duhet pasqyruar parasysh së pari, përkatësia e fenomenit të dhënë në modele të gjalla produktive; sistemi është një nga bazat e normës; së dyti, përdorimi i fenomenit, përhapja e tij¹⁷; më e zakonshme është ajo formë që takohet më shpesh. Duhet parë edhe norma e stileve të tjera të gjuhës letrare e në radhë të parë duhen vlerësuar edhe të dhënat e publicistikës. Së fundi, do marrë në konsideratë edhe ana funksionale stilistikore, kështu nëqoftëse njëri variant i normës dyvariantëshe do të ngrihet në normë të ngulitur, varianti tjetër mund të përdoret akoma, nëqoftëse ai shpreh një nuancë tjetër stilistikore; ose nëqoftëse përdoret në kushte të tjera ligjërimore. Kristalizimi i gjuhës letrare nuk duhet të kalojë në eliminimin e dallimeve të nevojshme funksionale-stilistikore. Në këtë rast të dy variantet do të përbënin dy mundësi të ndryshme shprehjeje, dy mjete gramatikore për një komunikim sa më të saktë e të hollë. Kjo do të thotë jo vetëm kristalizim i gjuhës letrare por edhe përsosje e zhvillim i saj.

Duke u nisur nga sa u tha më lart ne mendojmë që më e arësyeshme do të ishte që të ngriheshin në normë format *shiu*, *kaun*; *keni*, *jeni*; *kishte*, *ishte*; *flisnim*, *thërisnim*; *do të punoj*, *do të shkoj*, në vend të *shinë*; *kini*, *jini*; *kish*, *ish*; *flitnim*; *do punoj* etj. Duke ditur se disa nga format e fundit kanë ngjyrën e tyre stilistikore, p.sh. janë pak a shumë karakteristike për gjuhën e bisedës, për gjuhën e folur, në dallim nga të parat që janë më shumë të librave, ne mendojmë se ato duhen përdorur në gjuhën e personazheve për karakterizim. Nëqoftëse një variant ekzistues i jep diçka të re, e pasuron gjuhën letrare në një drejtim a në një tjetër, i jep variacione në thyerjen e monotonisë etj. etj., ky variant duhet përdorur dhe do ngritur në normë (një gjë e tillë do parë p.sh. për format e shkurtuara *kish*, *ish*, për të ardhmen e tipit *kam për të punuar* etj. pranë *kishte*, *ishte* e *do të punoj*) etj.

Përkundrazi, variantet që nuk i japin ndonjë gjë gjuhës letrare por që çojnë në shfaqjen e sinonimisë absolute të varianteve të normës, duhen mënjeluar. Kështu p.sh. nuk i lejohet një shkrimtari që pa asnjë kriter e arësye të caktuar, në të njëjtin kuptim, në të njëjtat rrethana përdorimi dhe në të njëjtën nuancë stilistikore të përdorë si t'i vijë herë *kishte* herë *kish*, herë *do të punoj* herë *do punoj* etj.

Përsa u përket shmangjeve qëndrimi ynë është i qartë, ato duhen flakur me vendosmëri, sa herë që nuk kanë një funksion të posaçëm dhe janë thjesht ndikime dialektore. Pra edhe shmangjet duhen parë pak a shumë me të njëjtin sy që u panë edhe normat dyvariantëshe.

Duhen mënjeluar ato shmangje që lindin nën ndikimin e dialektit ose të të folmeve, që përdoren pa ndonjë qëllim të caktuar e kur në përdorim nuk janë futur me vetëdije nga një shkrimtar.

Përkundrazi, kur një shmangje mund të kryejë një funksion të caktuar, ajo duhet përdorur pa tjetër për të gjallëruar më tej gjuhën letrare, për ta bërë atë më shprehëse e më të hollë. Le të marrim rastin e shumësit me *-ra* ose *-ër*. Ky lloj shumësi është përgjithësisht herë-herë pa vend. Shumësat e mirëfilltë me *-ra*, *-ër* të përfutur analogjikisht kur përdoren në kuptimin neutral duhen mënjeluar si shmangje. Por kur këta shumësa kanë edhe një vlerë stilistikore duhen përdorur dhe duhen ngritur në normë. P.sh. shumësi i mirëfilltë *shtëpëra* duhet mënjeluar, sepse normë

17) V.A. Ickovic, «Jazykovaja norma», 1968, f. 28,39.

përbën shumësi *shtëpi*, por nga ana tjetër, do të ishte shumë me vend, që të përdroreshin shumësat metaforikë *gostira*, *darkëra* etj. (pranë shumësive neutralë *gosti*, *darka*), në qoftë se format me *-ra* do të jepnin një nuancë suplementare. Në këto raste folësi apo autori nëpërmjet formës së shumësit mban edhe një farë qëndrimi emocional, duke shprehur një nuancë përbuzjeje ose një tjetër nuancë.

Natyrisht, për të bërë një normativizim sa më objektiv duhet një punë e madhe këmbëngulëse e sistematike; gjithashtu, për të përdorur normat e ngulitura sa më drejt në jetë duhet që ato të njihen sa më mirë, të përdoren e të zbatohen me kujdesin më të madh, duhet, së fundi, disiplinë dhe një nuhatje ligjërimore.

Kjo punë dhe ky kujdes janë të vazhdueshëm, sepse gjuha letrare kombëtare nuk qëndron në një gjendje standarte; ajo ndryshon e zhvillohet pa ndërprerje, sepse dukuri të reja lindin e shfaqen në të.

LISTA E VEPRAVE TË VJELA DHE SHKURTIMET

- Abdihoxha, A. Një vjeshtë me stuhi, Tiranë, 1952, 291 f. (A.A., Një...)
 » » Tri ngjyra të kohës, Tiranë, 1965, 317 f. (A.A., Tri...)
- Andoni, S. Tregime nga Morava, Tiranë, 1960, 143 f. (S.A., Tregime...)
 » » Kur merrnim fluturim. Tiranë, 1967, 223 f. (S.A., Kur...)
- Gjata, F. Ujët fle hasmi s'fle, Tiranë, 1951, 98 f. (F.Gj., Ujët...)
 » » Përmbysja, Tiranë, 1954, 451 f. (F.Gj., Përmbysja)
 » » Këneta, Tiranë, 1958, 489 f. (F.Gj., Këneta)
- Kacorri, Th. Për mëmëdhenë, Tiranë, 1961, 371 f. (Th.K., Për...)
- Kadare, I. Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë, 1963, 166 f. (I.K., Gjenerali...)
 » » Dasma, Tiranë, 1968, 224 f. (I.K., Dasma)
- Marko, P. Hasta la vista, botim i dytë, Tiranë, 1966, 556 f. (P.M., Hasta...)
 » » Stina e armëve, Tiranë, 1966, 534 f. (P.M., Stina...)
- Marko, P. Shpella e piratëve, Tiranë, 1967, 153 f. (P.M., Shpella...)
 » » Urata, dhia dhe perëndia, Tiranë, 1967, 157 f. (P.M., Urata)
- Musaraj, Sh. Isha unë Çobo Rrapushi, Tiranë, 1960, 120 f. (SH.M., Isha...)
 » » Para agimit, roman I, Tiranë, 1965, 506 f. II, Tiranë, 1966, 556 f. (Sh.M., Para... I, II)
- Musta, R. Njëpër agime, Tiranë, 1968, 48 f. (R.M. Njëpër...)
- Paçrami, F. Ngjarje në fabrikë, Dramë e botuar në Nëndori, 1968, Nr. 4, (F.P., Ngjarje...)
- Sako, Z. Buka jonë e përbashkët, Tiranë, 1965, 174 f. (Z.S., Buka...)
- Spasse, S. Ata nuk ishin vetëm, Tiranë, 1952, 272 f. (S.S., Ata...)
 » » Buzë liqenit, Tiranë, 1965, 364 f. (S.S., Buzë...)
- Shuteriqi, Dh. Çlirimtarët, roman I, Tiranë, 1952, 300 f. II, Tiranë, 1955, 363 f. (Dh. S., Çlirimtarët, I, II)

- Shuteriqi, Dh. Gurnecka, Tiranë. 1957, 176 f. (Dh.Sh., Gurnecka.)
- » » Kënga dhe pushka, Tiranë, 1963; 421 f. (Dh.Sh. Kënga dhe...)
 - » » Këngë në Minierë, Tiranë, 1968, 302 f. (Dh.Sh., Këngë...)
- Xoxa, J. Novela, Tiranë, 1949, 83 f. (J.X., Novela 1949)
- » » Novela, Tiranë, 1958, 156 f. (J.X., Novela 1958)
 - » » Lumi i vdekur, roman I, Tiranë, 1965, 256 f.; II, Tiranë, 1965, 320 f.; III, Tiranë, 1965, 255 f. (J.X., Lumi... I; II, III)

R é s u m é

QUESTIONS DE LA NORME MORPHOLOGIQUE
DANS LA LITTÉRATURE ARTISTIQUE D'APRÈS LA LIBÉRATION

Cette communication représente l'abrégé d'une variante plus ample, encore inédite, où trouvent une argumentation illustrative plus complète toutes les questions abordées ici.

L'auteur traite des questions de caractère théorique général ainsi que des faits concernant la stabilisation pratique de la norme morphologique. Elles sont traitées brièvement et présentées sous forme de conclusions.

L'auteur a examiné les caractéristiques principales de la norme morphologique dans la littérature artistique, il a analysé la catégorie de variabilité des normes morphologiques, a traité certaines des normes à deux variantes ou principales normes-doublets. Il a séparé à leur intérieur les normes-doublets, indiquant les causes de la naissance de celles-ci et la tendance qu'offre actuellement quelqu'une d'entre elles. De la catégorie de variabilité des normes il distingue exactement les écarts de la norme et fait état de quelques-uns des écarts qu'on observe actuellement dans la littérature artistique. L'auteur a indiqué, également, aussi l'attitude qu'on doit tenir envers les normes-doublets et envers les écarts. Il a abordé de passage aussi quelques différences de la norme morphologique en publicistique de celle de la littérature artistique. L'auteur a tendu son effort à brosser également quelques-uns des critères fondamentaux qu'on doit tenir présents pour l'allure normale de la norme morphologique.

Ci-dessous nous donnons brièvement les résultats acquis dans la communication: Après la libération, dans la littérature artistique sont observés les trois phénomènes suivants: 1) norme stabilisée unique; 2) norme à deux variantes ou norme-doublet; 3) écart de la norme.

Les normes uniques prédominent non seulement dans le système nominal mais également dans celui verbal. A côté des normes uniques, mais beaucoup plus rarement que celles-ci, sont usitées les normes à deux variantes. Outre les normes uniques et celles à deux variantes, l'auteur remarque dans beaucoup de cas aussi des écarts à la norme, écarts qui sont nombreux, plus variables que les normes-doublets, mais que, à différence de ces dernières, les écarts connaissent un usage plus circonscrit, une extension plus petite (puisqu'on les retrouve chez des auteurs particuliers, dans des productions données et avec une intensité faible d'usage).

Etudiant le caractère des phénomènes ci-dessus, Çeliku arrive aux conclusions suivantes:

I. La structure morphologique dans la littérature artistique après la libération offre, dans ses lignes générales, un caractère de stabilisation. Par rapport à la période d'avant la libération du pays et des années au lendemain de la libération, le processus de stabilisation et de normalisation a fait son chemin. Cela est confirmé par les faits suivants:

- 1) Les normes uniques sont les dominantes, tandis que celles à deux variantes sont en petit nombre. Les normes à deux variantes sont remarquées dans le pluriel des noms masculins (bilbilë: bilbila), à l'accusatif défini des noms masculins se terminant au radical par une voyelle accentuée (njeriun: njerinë); dans le système verbal on remarque les formes parallèles: keni: kini, jeni: jini, kishte: kish, ishte: ish, thërrisnim: thërritnim, do të punoj: do punoj, etc.
- 2) Quelques-unes des formes parallèles ont acquis un usage conditionné, chacune des variantes a un sens donné et est usitée dans des constructions données. Ainsi, p.ex., les noms neutres du type ujë-t sont en usage surtout dans les unités phraséologiques, tandis que dans l'usage neutre la norme est constituée par la forme du genre masculin (ujë-uj). Ce conditionnement date d'avant la libération. Conditionnées sont également les formes de l'ablatif en -sh et en -ve. Ce conditionnement est ancien. L'auteur a examiné les conditions de chacune de ces deux variantes.

Les normes à deux variantes conditionnées sont considérées par l'auteur comme des attestations d'une stabilisation plus effective de la norme, que celles non conditionnées, libres. L'auteur fait remarquer également des écarts des normes-doublets conditionnées.

Il a constaté également un conditionnement fonctionnel des constructions parallèles au moyen des prépositions nga, prej, qui actuellement, dans la littérature artistique, sont usitées rarement l'une pour l'autre. Le même phénomène a eu lieu aussi dans les constructions à prépositions më, në.

- 3) Quelques-unes des formes parallèles de la variante littéraire méridionale, qui avant la libération connaissaient un ample usage, ont été éliminées, passant l'une de ces formes en norme unique stabilisée, l'autre étant abouti à un écart. Ainsi dans lismë: lism a été éliminée la première à l'avantage de lism; le soi-disant «cas locatif» a cédé la place à l'accusatif indéfini; les formes de l'aoriste du type kapme, kaptë, kapnë ont été éliminées à l'avantage de kapëm, kapët, kapën.
- 4) Les normes à deux variantes ne s'étendent pas à l'entier système paradigmatique, mais à des seuls aspects particuliers de ces paradigmes, ainsi que dans des groupes donnés de mots ou dans de simples mots.

II. Du nombre des écarts on peut mentionner, p.ex., l'usage du neutre ujët en dehors des unités phraséologiques, l'accusatif lismë, le locatif në list, l'aoriste kapme et ceux de type shkrojti, lojti, le conjonctif të kapish, të kapi, etc.

III. Les normes-doublets ainsi que les écarts sont issus du développement objectif de la langue, des influences dialectales. Les causes de la naissance de normes-doublets et des écarts doivent être cherchées dans la spécificité du temps de la formation de la langue littéraire nationale albanaise, qui est relativement jeune.

IV. La plupart de nos écrivains reconnaissent et utilisent les formes morphologiques de la norme. Cela est rendu plus évident notamment

durant ces dernières années. Pourtant, il y a des hommes de lettres qui reflètent les influences locales de leur pays de naissance. Du nombre des écrivains on peut faire, aujourd'hui, quelques distinctions.

V. La langue de la littérature artistique offre plusieurs distinctions de la langue de la publicistique. L'auteur, après avoir évoqué les facteurs qui provoquent ces différences, arrête son regard sur les faits suivants: dans la littérature artistique sont conservées encore quelques formes anciennes, un grand nombre d'écarts; dans la publicistique les écarts sont plus circonscrits, l'influence du dialecte septentrional est plus grande.

L'auteur reproduit un cas où les variantes de la norme usitée respectivement dans la publicistique et la littérature artistique constituent une norme-doublet dans le seul cadre général de la langue littéraire nationale.

L'auteur parle également de la grande influence de la publicistique sur la langue de la littérature albanaise.

VI. L'attitude de l'auteur envers les normes-doublets et les écarts est la suivante: Pour ce qui est des normes-doublets il est nécessaire de faire un effort plus grand, une étude plus profonde en vue de connaître la tendance qu'a l'une ou l'autre variante et fixer la variante qui a le plus de raison et de possibilité d'être élevée à la dignité de la norme. Mais, on doit tenir présente aussi la possibilité de la spécification fonctionnelle de l'autre variante, par conséquent on doit prendre soin à ne pas élever en normes tout deux les variantes, naturellement avec des nuances fonctionnelles et stylistiques différentes.

En se basant sur quelques critères fondamentaux de normalisation, l'auteur croit que les formes shiun, keni, jeni, kishte, ishte, flisnin, do të punoj, sont les formes qui doivent être élevées en norme, tandis que les autres variantes parallèles: shinë, kini, jini, kish, ish, flitnim, do punoj ne pourraient trouver leur utilisation que sous un autre coloris stylistique.

Aussi les écarts doivent être vus du même oeil qu'on a vu aussi les normes-doublets. Les écarts doivent être éliminés quand ils voient le jour sous l'influence du dialecte et des parlars singuliers, lorsqu'ils sont usités sans un but précis, en d'autres termes sans une utilisation consciente.

Néanmoins, les écarts aussi peuvent intervenir dans la production en vue de caractériser les personnages, ils peuvent intervenir dans les cas où ils ont une fonction donnée (ainsi, à côté des pluriels proprement dits djem et vajza on peut usiter des pluriels métaphoniques djema, darkëra, gostira, etj.).

Ce travail est des premiers de son genre, c'est pourquoi toutes ces questions attendent d'être examinées plus à l'aise et de plus près.

